

KREJT SHOKËT E MI (pjesa 8)

I Themi Të Vërtetën Njëri-Tjetrit

Po lexoja një anketë të bërë kohët e fundit, ku pyetja e anketës ishte:

Sa të sinqertë janë njerëzit sot, a thonë të vërtetën apo gënjejnë?

Në përfundim të anketës këto ishin përgjigjet:

*Nëse është për të fituar më shumë lekë dhe gënjen, justifikohesh.

*Nëse duhet të gënjesh që të tregosh sesa i aftë je prapë justifikohesh.

*Po gënjeve kur të pyesin për një vend pune, a di këtë e atë, prapë justifikohesh.

Në 10 çifte të martuar; 7 thanë që i gënjejnë gratë e tyre.

Mund të gënjesh sa herë që të duhet për të shpëtuar nga një situatë e sikletshme.

Shumica thonë që njerëzit kanë qenë më të sinqertë në sistemin e mëparshëm, para demokracisë.

I bie që njerëzit nuk janë aq të sinqertë sa ç'kanë qenë, gënjeshtat dhe mashtrimet janë në rritje.

Pjesa tjetër e anketës ishte:

Cilin person gënjen më shpesh?

Përqindja më e lartë ishte sipas kësaj rradhe:

- 1) Prindërit
- 2) Shokët
- 3) Vëllezërit/motrat
- 4) Ata që i dua (burrin/gruan, të dashurin/ën)
- 5) Shefin, pronarin, mesuesin
- 6) Fëmijët.

Prandaj nuk ka më aq marrëdhënie të forta në familje, as miqësi të forta, sepse shumica gënjejnë. Sinqeriteti e bën të fortë një marrëdhënie, miqësi, por po ia zë vendin gënjeshtat dhe mashtrimi.

Bibla thotë:

1 Korintasve 13:6 "*Dashuria gëzohet me të vërtetën .*"

Efesianëve 4:15 "*Duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë (ta flasim të vërtetën, të sillemi dhe ta jetojmë), drejt atij që është kreu, Krishti*".

Mashtrimi i shkatërron shoqëritë. Nuk ka martesë që nuk shkatërrohet nëse nuk ka ndershmëri.

Jemi në pjesën e parafundit të serisë "**Krejt Shokët e mi**", sot do të shohim: "*Si t'i themi të vërtetën njëri-tjetrit.*"

Perëndia na jep 4 mënyra në Bibël për këtë gjë.

Nëse do që të kesh marrëdhënie, miqësi të forta, duhet ta thuash të vërtetën në këto katër mënyra.

1. Thuaje të vërtetën vazhdimisht.

Thuaje të vërtetën gjithmonë. Nëse një burrë i thotë gruas, *“Unë do të jem besnik ndaj teje plot 6 ditë në javë,”* nëse ai nuk është besnik gjithmonë, nuk është besnik fare.

E njëjta gjë me sinqeritetin, nëse nuk thua të vërtetën gjithmonë, ti po gënjen, je gënjeshtar.

Pyetje për beqarët: Cila është një nga cilësitë e para që do të doje të kishte personi me të cilin do martoheshe?

Të jetë i/e sinqertë. Sepse asnjë nga ne nuk do që të na gënjejnë apo ta thonë të vërtetën gjysma-gjysma apo një ditë të gënjejnë, një ditë të thonë të vërtetën.

Fjalët e Urta 13:17b *“Lajmëtari besnik sjell shërim.”*

Ai që thotë të vërtetën me besnikëri, ai që e thotë gjithmonë të vërtetën sjell shërim. Sepse çdo miqësi është e ndërtuar mbi besimin te personi tjetër. Por besimi tek një person ndërtohet kur ai të thotë të vërtetën, besimi dhe e vërteta janë të lidhura ngushtë.

A do të ndërtosh besim tek të tjerët? Thuaj gjithmonë të vërtetën.

Fjalët e Urta 28:23 *“Kush qorton dikë ka për të gjetur favor më të madh se ai që i bën lajka me fjalë.”*

Gënjeshtria e shkatërron suksesin, sepse e vërteta qëndron, por gënjeshtria del shpejt në shesh.

Sa i sinqertë je ti në shtëpi, në lidhje, në punë, në shkollë? Disa nga gënjeshttrat më të mëdha në ditët e sotme:

1. Kur shkon pyet për një punë, *“Ma lër numrin e celularit se ju marrim vete në telefon.”*

3. Kamarieri, *“Do ta sjell porosinë për një minutë.”*

4. Reklammat, gënjejnë pafund.

5. Kur blen një mall me garanci, lexon fletën dhe aty thuhet, *“Nuk të garantojmë për këtë e për këtë e për këtë,”* po për çfarë të garantoni pra?!

6. Kur shkon në dyqan për të blerë diçka dhe shitësi të thotë, *“Të rri mirë, shiko sa mirë, bleje se të rri mirë.”*

7. Kur dikush shet një makinë të përdorur, të shkundur, *“Bën kaq, e bën aq, është e mirë, është e re.”*

8. Siguracionet e makinave, para se të bësh aksident, *“Ne të ndihmojmë, të gjendemi afër, do të japim dëmin.”* Kur ndodh aksidenit, mbyllin derën, *“S’jam këtu, hajde më vonë.”*

9. Shitësi i dyqanit kur e pyet për një prodhim që do ta blesh, “*Si është kjo?*” “*Po po është e mirë e kam provuar, është super, merre dhe provoje por paguaj para.*”

10. Pronari te puna jote, javën e parë kur ti fillon punën është shumë i dashur, i kujdesshëm. Pas një jave, “*Pse se ke bërë këtë, po këtë, po atë, ti s’ja thua për këtë punë.*”

Fatkeqësisht ne i besojmë njerëzit më pak se më para. Për shkak se njerëzit janë të zhgënjyer. Prandaj thuaj të vërtetën gjithmonë.

2. Thuaje të vërtetën e plotë.

Mos bëj lojra, ji i drejtpërdrejtë, mos e thuaj të vërtetën e përgjysmuar.

Fjalët e Urta 10:10a “*Kush e shkel syrin shkakton vuajtje... .*”

Çfarë lloj vuajtjeje? Mosbesim, dyshim, hidhërim, zemërim. Ata që e thonë të vërtetën e përgjysmuar nuk kanë shoqëri të forta, por të cekëta.

Pse shumë persona përmbahen e nuk e thonë të gjithë të vërtetën? Sepse kanë frikë. Duan të shmangin konflikte. Ata mendojnë se po e treguan të gjithë të vërtetën do plasi sherri, nuk duan të nisin sherr.

Unë kam një shok që e dua shumë, ai gjithmonë, sa herë nis të më thotë diçka, e nis, sa e fillon, thotë “Lerë lëre, s’po ta them më mirë.” Kjo të acaron shumë.

“Mos ma thuaj më mirë, mos e nis fare, jo ta lësh përgjysëm.”

Ideja sot është, “Mbaje mirë me të gjithë, mos bëj sherr në shoqëri.” Por nuk funksionon gjithmonë.

Disa nga ju nuk po i nxirrni ndjenjat që keni tamam tamam brenda vetes në lidhje me prindërit, shokët, burrin/gruan, shefin, mësuesin, të afërmin, komshiun.

Ti po fsheh atë që ndjen tamam tamam sepse ti ke hallin se do e shkatërrojë marrëdhënien, miqësinë. Por, e vërteta është se ti po e shkatërron atë gjë pak nga pak.

Fjalët e Urta 28:23 “*Kush qorton dikë ka për të gjetur favor më të madh se ai që i bën lajka me fjalë.*”

Por zakonisht, kur je i hapur me dikë—kur i thua të vërtetën—në fillim ka shumë pakënaqësi dhe është e vështirë, disa herë krijon dhe dhimbje. Ka zemërim dhe emocione të frikshme. Në teori ne të gjithë biem dakort, që sinqeriteti është mënyra më e mirë. Por kur vjen puna për ta praktikuar, kur vjen rradha jote, ti mendon, ‘*Ndoshta nuk është sot dita për të qenë i sinqertë, do ta provoj nesër.*’ Ne gjithmonë e kemi një justifikim. ‘*Nëse ua them prindërve të vërtetën, ata do të më nxjerrin nga shtëpia.*’ ‘*Nëse ia them shefit të vërtetën për atë gabimin që bëra, do të më pushojë nga puna.*’ ‘*Nëse i them burrit/gruas sesi ndihem, atij/asaj do t’i iki truri.*’ ‘*Nëse ia them gruas të gjitha acarimet dhe*

pasiguritë që kam në vetvete ajo do të shohë se sa të paaftë që e paska burrin. 'Nëse ia them pastorit se çfarë mendoj unë për predikimet e tij'

POR, shmangia sjell vetëm një gjë: Krijon më shumë probleme, i shton, e përkeqëson situatën. Ti po shtyn diçka që është e pashmangshme kur nuk thua të vërtetën. Dhe ajo që po ndodh, është se ti po lëndon veten tënde dhe marrëdhëniet, miqësitë me të tjerët.

Nëse do që të tjerët të besojnë në atë që thua, duhet të tregosh të vërtetën e plotë. Ji i sinqertë dhe i hapur me njerëzit. Një përgjigje e sinqertë është shenjë e një miqësie të mirë. Por të jesh i sinqertë, i drejtpërdrejtë, nuk do të thotë të jesh i ashpër, i dhunshëm. Shiko cilësinë e tretë që thotë Perëndia:

3. Thuaje të vërtetën me dashuri.

Mos e përdor të vërtetën si kamzhik.

Efesianëve 4:15a *"Duke e thënë të vërtetën me dashuri."*

Jo me inat, me zemërim, urrejte, duke ushtruar presion mbi tjetrin, por i shtyrë nga dashuria.

Mendo për një person që do ta ndihmosh të ndryshojë. Dy fakte kur do t'i ndihmosh njerëzit të ndryshojnë:

1. Njerëzit ndryshojnë më lehtë dhe më shpejt kur e vërteta është e mbështjellë me dashuri.
2. E vërteta pa dashuri do të hasë kundërshtim. Do të kthehet në manipulim. Do të duket si një sulm ndaj të cilit duhet të mbrohesh.

Shumica e martesave nuk e thonë të vërtetën sepse ata luajnë rolet e sulmuesit dhe të mbrojtësit.

Bisedë mes një çifti, Sazani dhe Shpresa:

Shpresa: Kur do ta rregullosh atë lavaman të shkretë që ka një vit që pikon? Ma ka sjellë në majë të hundës.

Sazani: Ku më le kohë të lirë ti mua! Nuk e mban mend se çfarë më kërkove të bëja dje dhe më shkoi gjithë dita mbas teje?

Shpresa: Ti vetë the që doja ta çoje vëllain tim pas dreke me makinë tek shtëpia e tij. Pastaj më thua *"Të detyrova unë."* Nuk ka rëndësi se sa me butësi t'i kërkoj unë gjërat, ti përsëri e ke mendjen vetëm si ta nisësh sherrin.

Sazani: Ti e nise e para. Unë vetëm po të them pse nuk e kam rregulluar lavamanin. Ti gjithmonë pret nga unë të bëj më shumë se sa kam mundësi.

Shpresa: Po pres unë shumë nga ty?! Vetëm ti s' duhet ta hapësh gojë more burrë. Shiko sa e gjatë është lista e gjërave që më kërkon ti mua për të bërë dhe më e keqja është se ti s' më ke thënë një herë të vetme faleminderit.

A ju duket si muhabet i dëgjuar ky? U harrua fare përse filloi muhabeti. Shpresa me Sazanin janë vetëm në sulm-mbrojtje dhe u harrua fare lavamani. E vërteta humbet rrugës mes atij që sulmon dhe atij që mbrohet. Njerëzit e përdorin këtë

Iloj mënyre për të shmangur atë që duan të thonë ose bëjnë ose për t'iu shmangur dëgjimit të asaj se çfarë ka për të thënë ai tjetri.

Alternativa tjetër e kësaj është ta thuash të vërtetën me dashuri.

Nga ta kuptoj që po ia them apo jo të vërtetën me dashuri atij tjetrit?

Efesianëve 4:29 “*Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t’u japë hir atyre që dëgjojnë.*”

Nëse e bën për të mirën e tyre kjo vjen sepse ti e do atë person. Nëse e bën për të mirën tënde, nuk është dashuri. Ajo që është e mirë për ndërtim—disa herë e vërteta të lëndon, të ther në zemër, por duke e parë më larg se aq është ndihmuese.

Përse po e thua? Mund të jetë e vërtetë, por a është ndërtuese? Nëse jo, mos e thuaj. Thuaji apo ndaj me tjetrin atë gjë me të cilën ti e ndihmon, e ndërton atë tjetrin sipas nevojës që ai ka. Pra, cili është motivit yt?

Thamë që duhet ta thuash të vërtetën vazhdimisht, të plotë dhe ta thuash me dashuri. Cila është e katërta, e fundit?

4. Thuaje të vërtetën me takt.

Herë pas here do të të duhet të ndash me të tjerët të vërteta të forta. Kjo është e vërtetë, nuk është e lehtë, apo argëtuese. Në të vërtetë ti nuk do që t’ia thuash, në fakt as ai tjetri nuk do ta dëgjojë, por duhet thënë. Sepse miqësia, marrëdhënia me të po shkon shumë poshtë.

Zakonisht kur ne ndodhemi në situata të tilla, gënjejmë dhe nuk kemi guximin për t’u përballur më atë që është tamam thelbi i çështjes. Sepse ne duam ta ruajmë harmoninë, mos të krijojmë konflikte në marrëdhënie.

Kur ti duhet ta thuash një të vërtetë të fortë, të vështirë, përgjigja e kësaj dileme është të mos gënjesh, por ta thuash me takt, me lezet.

Çfarë kuptimi ka ta thuash me takt, me lezet? Takt është të arrish ta sqarosh muhabetin pa u bërë armik me atë tjetrin.

Fjalët e Urta 12:18 “*Kush flet pa mend është si ai që shpon me shpatë, por gjuha e atyre që flasin me urtësi sjell shërim.*”

Dy fjalë, “shpon” dhe “shërim”. Kur thua të vërtetën ke mundësinë ose për ta lënduar dikë me të vërtetën, ose për ta shëruar atë person me të vërtetën.

Cili është motivi im? A po e them me dashuri? A po e them me takt? A dua ta shëroj atë tjetrin me të vërtetën, jo ta lëndoj?

Si mund të jesh me takt kur thua të vërtetën?

Dy mënyra që gjenden në dy vargjet e fundit:

Planifikoje atë që do të thuash.

Mendoje para se ta thuash, si t’ia tregosh atij tjetrit të vërtetën, sepse ti e di që

është e vërtetë e fortë, nuk ka për ta pranuar kollaj, kështu që planifikoje atë që do të thuash.

Fjalët e Urta 16:21b “...ëmbëlsia e buzëve e shton diturinë.”

Zgjidh kohën e duhur

Koha ka shumë rëndësi kur bisedon me dikë.

Predikuesit 8:6a “Sepse për çdo gjë ka një kohë... .”

E vërteta + taktin, ta thuash me lezet + koha e duhur = shoqëri, miqësi, marrëdhënie të mira, sepse vjen nga një komunikim i mirë, dhe komunikimi i mirë është çelësi i një miqësie të mirë. E vërteta, takti, koha, janë së bashku.

Nëse janë këto të treja, ti po thua diçka të vërtetë, por po ia the personit të gabuar, në mënyrën e gabuar, në kohën e gabuar, për arsyen e gabuar, e di cila është fjala e duhur për këtë?

Thashethem.

Bibla thotë se është gabim, megjithëse ajo që po thua është e vërtetë. Ke nevojë për **të vërtetën, taktin, kohën**. Ti e ke parë nga përvoja jote, ti hedh një bombë në shoqërinë tënde dhe fillon sherri. Mendoje, kur është koha më e mirë për të thënë diçka, jo sa ta shohësh, “*Hajde se ty të prita.*”

Ka një kohë dhe një mënyrë të duhur për të bërë çdo gjë. Ndoshta ti ndihesh gati për ta ndarë atë vërtetë, por a është gati ai që do e dëgjojë?

Nëse do që ta bësh me dashuri, thuaje të vërtetën në kohën kur dhe tjetri është gati.

Pse ta vrasësh mendjen kaq fort—jo thuaje vazhdimisht, thuaje të plotë, me takt, planifikoje, gjej kohën e duhur. Pse ta lodhësh trurin kaq fort? Pse mos ta thuash kur të të vijë për ta thënë, ashtu si të të vijë për mbarë ty?

Për shkak se ti dhe unë jemi të interesuar tek rezultatet që duam nga ajo që themi. Nëse e thua të vërtetën siç duhet rezultatet do jenë të mrekullueshme.

Bibla thotë tek

1 Gjonit 1:7 “Nëse ecim në dritë ... ne kemi bashkësi (miqësi).”

Çfarë është miqësia, bashkësia? Është marrëdhënia e vërtetë, miqësia e fortë, është shoqëri e afërt, është mbështetje. Dhe ka vetëm një mënyrë për ta bërë këtë gjë: Duke thënë të vërtetën.

Ndaj kujt nuk je i sinqertë? Kujt nuk po ia tregon të vërtetën? Kjo gjë të lëndon dhe ti e kupton këtë gjë. Por ti nuk merresh me të. Mos u bëj frikacak, por merru me këtë gjë.

Çfarë po hiqesh sikur nuk e di? Ka një problem në marrëdhëniet, miqësitë e tua, dhe ti hiqesh sikur nuk di gjë. Përse Perëndia i qepet kaq shumë pas të vërtetës?

Sepse Ai është e vërteta. Ai gjithmonë tregon të vërtetën.

Nëse ti je besimtar, nëse ti thua me gojën tënde që do ta ndjekësh Jezus Krishtin, atëherë duhet të thuash të vërtetën. Nuk ke mundësi tjetër. Jezusi tha, “*Unë jam e vërteta.*” Nëse ti do që të bëhesh si Krishti atëherë duhet ta thuash të vërtetën.

E vërteta të lëndon për momentin, por në afat të gjatë ka për të sjellë ndryshim.

Unë shpresoj që ti jo vetëm do thuash që dëgjove një mesazh të mirë sot, por ti do ta zbatosh vetë, që ti do të bëhesh bërës i Fjalës. Unë dua që secili prej jush të rrezikojë këtë javë duke thënë të vërtetën në çdo rast. Filloje me njerëzit e shtëpisë apo me shoqërinë e ngushtë. Nuk ka për të qenë e lehtë.

Por ti sot, bëj këtë përkushtim: **Do jem person që thotë të vërtetën!**

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.